



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-1/298-10, duke përshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sport, përmes Thirrjes publike të dt. 04.04.2018, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për financimin publik të OJQ-ve, për programet/projektet sipas Thirrjeve publike në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore dhe të aktiviteteve sportive publikuar më 30.03.2018, themelohet komisioni në përbërje:

1. Jakup Gashi, kryesues, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
2. Kadrie Ajvazi, anëtare, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Fitore Blakçori, anëtare, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
4. Donjetë Sheqiri, anëtare, Shoqëria civile
5. Labinot Podvorica, anëtar, Shoqëria civile

z. Agim Idrizi, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyra dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Arkivit

Nr. 02-020/04-0031933/18
Podujevë, 18 prill 2018



Kryetari i Komunës
Agim Veliu